



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.06.2022

**MBLEDHJA Nr. 26,  
Datë 13.06.2022, ora 10:30  
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 13.06.2022, ora 10:30**, do të zhvillohet mbledhja nr. 26 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019, “Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline AG Albania, e regjistruar pranë QKB, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), Trans Adriatic Pipeline AG”, i ndryshuar
2. Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Hec-i Kabash Poroçan” sh.p.k.
3. Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Albesp Trading & Consulting” sh.p.k.
4. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI  
Petrit AHMETI**